REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 694/20
Datë/Datum. 05-10-2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit* 25.09.2020	*Data e dorëzimit të raportit* 05.10.2020	Nr. i lëndës: 694/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.09.2020, OE "Rojet e Nderit "sh.p.k- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 694/20, kundër Njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me nr. të prokurimit: **214-20-3540-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria E Punëve Të Brendshme.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **2,099,995.20 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.547/20i dt:28.08.2020
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të nderuar,
Ju drejtohemi me këtë ankesë pasi që po të mos ishte mundësia do ishte e pamundur që të mundohemi të mbrojmë të drejtat e punëtorëve .

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar DT ku kemi parë kriteret , të cilat janë të arritshme por një ndër kriteret që nuk ka ndonjë bazë për kalkulim ose siguri të ofertës dhe nuk garanton respektim të drejtave të punëtorëve është kriteri ku keni cekurë:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të bashkëngjesin një deklaratë të nënshkruar dhe të vërtetuar, ku deklaron se do ta respektojë Vendimin e qeverisë nr . 04 33 të datës 17.08.2011 në lidhje me lartësinë e pagës minimale në nivel nacional, në Republikën e Kosovës, si dhe çdo vendim tjetër që mund të nxirret nga Qeveria e Kosovës në të ardhmen për respektimin e pagave minimale në nivel nacional .

Edhe pas disa kërkesave për sqarim sqarimet tuaja kanë qenë jo të duhura dhe kanë lënë hapsirë për manipulim të çmimit pasi që për deri sa nuk ka diçka të matshme lidhur me çmimin që duhet të ofrohet por edhe të shkelën të drejtat elementare të punëtorëve që i takojnë sipas Ligjit të Punës. Më poshtë po i bashkangjesim pyetjet dhe përgjigjeje tuaja ku është cekur se :

1.	*Gjate analizimit te saj verejtem se nuk keni* percaktuar page minimale baze, mirepo vetem keni kerkuar respektimin e Vendimit te qeverise nr. 04/33 te dates 17.08.2011 ne lidhje me lartesine e pages minimale ne nivel nacional. Andaj kemi nevoj per sqarime shtese si vijon: Vendimi i lartecekur eshte vendim i cili ben diskriminim te puntoreve, bazuar ne moshen e tyre se a jane nen 35 vjec apo mbi 35 vjec, a e keni parapare qe te gjithe te punesuarit te paguhen ne shumen prej 170.00€ me qellim qe mos te kete diskriminim mes tyre?	Është nën përgjegjësinë e Juaj, ta respektoni Vendimin e qeverise nr. 04/33 te datës 17.08.2011 ne lidhje me lartësinë e pagës minimale ne nivel nacional.
2.	A keni parapare qe ne përcaktimin / perllogaritjen e pages te perfshihen te gjitha obligimet ligjore apo te respektohet vetem pjeserisht ligji?	Secili Operator Ekonomik është përgjegjës për respektimin Ligjin e Punës Nr.03 L-212 dhe akteve tjera nënligjore.
3.	A duhet te inkorporohen ne cmim oret e nates, oret gjate vikendeve, pushimet vjetore, pushimet mjekesore, festat zyrtare, etj?	Kjo fushë është e rregulluar me Ligjin e Punës Nr.03 L-212 dhe është obligim që ta zbatoj çdo Operator Ekonomik.
4.	A duhet te inkorporohen ne cmim shpenzimet e OE dhe fitimi i parapare?	Në politikat e çmimeve nuk ka të drejtë të përzihet Autoriteti Kontraktues.

Me këto përgjigjeje sqaruese ju na e keni vështrisuar edhe më shumë qështjen e kalkulimit të çmimit pasiqe edhe pse jemi të detyruar që të respektojm Ligjin e Punës nuk keni cekur se cilat nga të drejtat e punëtorëve duhet respektuar si pas këti ligji dhe nëse ndonjë OE nuk i respekton a do të eliminiohet si i papërgjegjëshëm .

Është shumë jo profesionale dhe jo etike të mos caktoht nje prag lidhur me kalkulimet se cilat ligje duhet të respektohen dhe nese nuk respektohen a do të eliminohen OE.

Kërkojm që të aprovoni kërkesen tone për rishqyrtim dhe të rishqyrtoni kriteret tuaja duke vendosur kritere të qarta dhe duke krijuar mundsi për punëtorët që do të shërbejn në inistucionin tuaj të jenë me të drejta si kurse ata në sektorin publik .

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "XX" - PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë i OE është se pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar DT ku kemi parë kriteret, të cilat janë të arritshme por një ndër kriteret që nuk ka ndonjë bazë për kalkulim ose siguri të ofertës dhe nuk garanton respektim të drejtave të punëtorëve është kriteri ku keni cekurë: Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të bashkëngjesin një deklaratë të nënshkruar dhe të vërtetuar, ku deklaron se do ta respektojë Vendimin e qeverisë nr . 04 33 të datës 17.08.2011 në lidhje me lartësinë e pagës minimale në nivel nacional , në Republikën e Kosovës , si dhe çdo vendim tjetër që mund të nxirret nga Qeveria e Kosovës në të ardhmen për respektimin e pagave minimale në nivel nacional .

Edhe pas disa kërkesave për sqarim sqarimet tuaja kanë qenë jo të duhura dhe kanë lënë hapsir për manipulim të çmimit pasi që përderi sa nuk ka diqka të matëshme lidhur me çmimin që duhet të ofrohet por edhe të shkelën të drejtat elementare të punëtorëve që i takojn sipas Ligjit të Punës. Më poshtë po i bashkangjesim pyetjet dhe përgjigjëjet tuaja ku është cekur se :

1.	*Gjate analizimit te saj verejtem se nuk keni* percaktuar page minimale baze, mirepo vetem keni kerkuar respektimin e Vendimit te qeverise nr. 04/33 te dates 17.08.2011 ne lidhje me lartesine e pages minimale ne nivel nacional. Andaj kemi nevoj per sqarime shtese si vijon: Vendimi i lartecekur eshte vendim i cili ben diskriminim te puntoreve, bazuar ne moshen e tyre se a jane nen 35 vjec apo mbi 35 vjec, a e keni parapare qe te gjithe te punesuarit te paguhen ne shumen prej 170.00€ me qellim qe mos te kete diskriminim mes tyre?	Është nën përgjegjësinë e Juaj, ta respektoni Vendimin e qeverise nr. 04/33 te datës 17.08.2011 ne lidhje me lartësinë e pagës minimale ne nivel nacional.
2.	A keni parapare qe ne përcaktimin / perllogaritjen e pages te perfshihen te gjitha obligimet ligjore apo te respektohet vetem pjeserisht ligji?	Secili Operator Ekonomik është përgjegjës për respektimin Ligjin e Punës Nr.03 L-212 dhe akteve tjera nënligjore.
3.	A duhet te inkorporohen ne cmim oret e nates, oret gjate vikendeve, pushimet vjetore, pushimet mjekesore, festat zyrtare, etj?	Kjo fushë është e rregulluar me Ligjin e Punës Nr.03 L-212 dhe është obligim që ta zbatoj çdo Operator Ekonomik.
4.	A duhet te inkorporohen ne cmim shpenzimet e OE dhe fitimi i parapare?	Në politikat e çmimeve nuk ka të drejtë të përzihet Autoriteti Kontraktues.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkesë e AK ka qene:

c.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të bashkëngjesin një deklaratë të nënshkruar dhe të vërtetuar, ku deklaron se do ta respektojë Vendimin e qeverisë nr. 04 33 të datës 17.08.2011 në lidhje me lartësinë e pagës minimale në nivel nacional, në Republikën e Kosovës, si dhe çdo vendim tjetër që mund të nxirret nga Qeveria e Kosovës në të ardhmen për respektimin e pagave minimale në nivel nacional.	**c. Deklaratë e nënshkruar dhe e vërtetuar (origjinal).**

Bazuar ne kërkesën e AK-se si me larte dhe në sqarimet shtesë të ngarkuara në platformen elektronike të prokurimit publik nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa, dëshmia dhe sqarimet e AK-së jan të qarta të sakta dhe precize. Andaj për të plotësuar dëshminë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duhet të bashkëngjesin një deklaratë të nënshkruar dhe të vërtetuar, ku deklaron se do ta respektojë Vendimin e qeverisë nr. 04 33 të datës 17.08.2011 dhe Ligjin e Punës në Republiken e Kosovës.

Me tej eksperti shqyrtues sqaron se nuk është në përgjegjësin e AK qe të përcaktoj se a është diskriminues vendimi në fjalë i nxjerr nga Qeveria e Kosovës në lidhje me moshën dhe pagën e punëtoreve, si rrjedhojë është nën përgjegjësinë e OE, ti respektoj vendimet dhe ligjet në fuqi. Po ashtu në përllogaritjen e pagës të përfshihen te gjitha obligimet ligjore dhe të respektohet Ligji i Punës Nr.03 L-212. Anadaj bazuar ne sqarimet qe u dhan më lartë del se ky pretendim ankimor nuk qendron

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që AK të vazhdoj me hapat tjerë në këtë aktivitet te prokurimit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MPB.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "ROJET E NDERIT". SH.P.K